



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E PASTRIMIT**

NJOFTIM

**"PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E
PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE URBANE,
BASHKIA KAMËZ".**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 8, neni 23, pika 10, neni 54, shkronja k, në zbatim të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar, Vendimit nr. 319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e msave për kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve", Urdhërit nr. 131, datë 27.01.2025 "Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e planit te menaxhimit të integruar të mbetjeve", si dhe në kuadër të hartimit të planit vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz, si një detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji nr.10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" ku përcaktohet se: "Çdo Njësi e Qeverisjes Vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji", Ndërmarrja e Pastrimit, Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Shoqatën "Bashki të forta" , ka përgatitur një draft për Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane.

Plani Lokal i Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të

përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Në vijim të procesit me konsultimin me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike pranë Pallatit të Kulturës më datë **18.03.2025**, ora **16:00**.